



ARGUMENTUM

news opinion analysis



Qeveria “Rama 4” nis zyrtarisht detyrën

- Rotacioni, jo përrallë por domosdoshmëri demokratike!
- SHBA propozon planin e paqes në Gaza,
- Vizioni Strategjik i Kinës në Samitin SCO 2025

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 SPECIALE

- Qeveria e re ‘Rama 4’ betohet në Presidencë dhe nis mandatin zyrtarisht.

05 OP/ED

- Rotacioni, jo përrallë por domosdoshmëri demokratike!

07 JO VETEM LAJMI

- Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë dënon sulmin rus me dronë në territorin polak.
- SHBA propozon planin e paqes në Gaza, përfundim i luftës dhe kthim i pengjeve.

11 FOKUS

- ELEFANTI NË DHOMË

13 REALPOLITIK

- Kthesë apo thikë me dy presa?! Stuhia palestineze në Nju Jork! Sa ndryshime në krye të diplomacisë!

15 POLITIKË

- “Shqipëria 2030 në BE”: Fjalimi i Kryeministrit Rama në hapjen e legjislaturës së re.
- Presidenti Begaj takon Trump: Miqësia shqiptaro-ameri-

kane, lidhje e pathyeshme.

19 RAJONI

- SHBA pezullon dialogun e planifikuar strategjik me Kosovën, shkak deklaratat e Kryeministrit Kurti.

20 BOTA

- “Iniciativa për Qeverisjen Globale”: Vizioni Strategjik i Kinës në Samitin SCO 2025.
- Lavrov akuzon Perëndimin në OKB për minimin e paqes në Ballkan.

ENGLISH EDITION

23 IN FOCUS

- U.S.A.–Kosovo strategic cooperation is vital for ensuring peace and stability in the region and in Europe.

24 OP/ED

- From Kaliningrad to Belgrade: Euro-Atlantic Threat Cordon.

26 REALPOLITIK

- The Troika that defies the West!

29 GLOBAL

- Azerbaijan and the conflict with Armenia over the Nagorno-Karabakh region!

QEVERIA E RE ‘RAMA 4’ betohet në Presidencë dhe nis mandatin zyrtarisht



Më 19 shtator 2025, Kryeministri Edi Rama dhe kabineti i tij i ri qeveritar u betuan zyrtarisht para Presidentit të Republikës në Presidencë, duke shënuar fillimin e mandatit të katërt radhazi të Partisë Socialiste në drejtimin e vendit. Ky moment konsolidon një periudhë të gjatë qeverisjeje të së majtës në Shqipëri, që prej vitit 2013, dhe përfaqëson një fazë të re politike, me sfida të reja ekonomike, shoqërore dhe integruese për vendin. Pas leximit të Dekretit të Presidentit për emërimin e Këshillit të Ministrave, ministrat e rinj u betuan me dorën mbi Kushtetutë sipas formulës së betimit: “Betohem në nderin tim, se do të zbatoj me përpikmëri Kushtetutën dhe ligjet, si dhe do të kryej me përgjegjësi detyrën shumë të rëndësishme që më është besuar, të anëtarit të Këshillit të Ministrave!”

Kryeministri Rama zhvillon mbledhjen e parë të qeverisë së re

Pas betimit në Presidencë, Kryeministri Edi Rama zhvilloi sot në ambientet e Kryeministrit mbledhjen e parë të Këshillit të Ministrave me kabinetin e ri qeveritar.

Pas ceremonisë së betimit para Presidentit të Re-

publikës, Bajram Begaj, Kryeministri Rama dhe 16 ministrat e kabinetit qeveritar u drejtuan godinës së Kryeministrit, duke ecur përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit”.

Ashtu siç e parashikon edhe protokoli zyrtar, Kryeministri Rama dhe ministrat e kabinetit qeveritar realizuan fillimisht foton familjare në shkallët e Kryeministrit dhe më pas u drejtuan sallës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.

Qeveria “Rama 4” vjen pas fitores së Partisë Socialiste në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, duke ruajtur shumicën në Kuvend dhe duke konfirmuar besimin e një pjese të konsiderueshme të elektoratit në vazhdimësinë e reformave të ndërmarra. Programi qeverisës i këtij mandati pritet të fokusohet në rritjen ekonomike të qëndrueshme, përsheptimin e procesit të integritetit europian, modernizimin e administratës publike, si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shërbimeve publike.

Ky mandat shënon gjithashtu një test të rëndësishëm politik për lidhshmërinë e Kryeministrit Rama dhe për aftësinë e Partisë Socialiste për të përballuar sfidat e një dekade të re në pushtet, në një klimë të re sociale dhe ekonomike brenda dhe jashtë vendit.



Qeveria e re u dekretua me këtë përbërje

Z. Edi Rama

Kryeministër; Kryeministri ushtron dhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale Diella.

Znj. Belinda Balluku

Zv.kryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Znj. Albana Koçiu

Ministër i Brendshëm

Znj. Elisa Spiropali

Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Z. Petrit Malaj

Ministër i Financave

Z. Blendi Gonxhja

Ministër i Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Z. Sofjan Jaupaj

Ministër i Mjedisit

Znj. Mirela Kumbaro Furxhi

Ministër i Arsimit

Znj. Evis Sala

Ministër i Shëndetësisë dhe Mirë-qenies Sociale

Znj. Delina Ibrahimaj

Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit

Z. Besfort Lamallari

Ministër i Drejtësisë

Z. Pirro Vengu

Ministër i Mbrojtjes

Z. Andis Salla

Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Z. Ervin Demo

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Znj. Majlinda Dhuka

Ministër Shteti dhe Kryenegociatore

Znj. Adea Pirdeni

Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Z. Toni Gogu

Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Rotacioni, jo përrallë por domosdoshmëri demokratike!

Nga DR. JORGJI KOTE

Mjeshtër i Madh

EKSKLUZIVISHT PER ARGUMENTUM

Në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS-së më 11 Shtator, Kryetari i saj, Edi Rama e quajti rotacionin politik demokratik “përrallë” duke iu referuar me gjysmë zëri Suedisë, Norvegjisë dhe Suedisë. Madje, ai u tha asambleistëve socialistë të mos i besojnë atyre që i tregojnë këto përralla. E habitshme, sepse dihet që “përralla treguesit” e këtij parimi të shenjtë të demokracisë liberale janë institucionet më të rëndësishme ku ne jemi ose po duan të anëtarësohemi sa më shpejt: OSBE-ja me Aktin Final të Helsinkit ku ne ”bëmë be dhe rrufe” derisa hymë, KiE-ja, NATO dhe sidomos BE-ja.

Madje, në atë fillim të viteve 90, ishin ato që na mësuam dhe edukuan me frymën dhe praktikën e rotacionit partiak, si kusht, kriter dhe kërkesë e domosdoshme e demokracisë pluraliste, si tipari kryesor që e dallon atë nga monizmi dhe diktatura. Tregojnë se Stalini nuk e donte demokracinë sepse sipas tij, “aty nuk dihet se kush fiton”. Ndërsa në kohën e monizmit rotacioni politik mohohet me argumentin se PPSH-ja përfaqësonte interesat e të gjithëve, ndaj nuk ishte fare nevoja për parti tjetër dhe ca më pak nga opozita, ose me fjalë të tjera rotacioni!

Por le të qëndrojmë pak te pohimi i çuditshëm mbi “përrallën



“ e rotacionit, që urojmë të jetë ” lajthitje” e çastit ose mosnjohje e fakteve historike. Ndryshe, ajo deklaratë mund të jetë synim i hapur për një monizëm të ri por me vello pluraliste.

Fakte të panumurta nga përvoja politike europiane dhe amerikane tregojnë qartë se rotacioni politik në demokracinë pluraliste është faktori dhe avantazhi vendimtar që ka kontribuar në arritje të mëdha politike dhe social-ekonomike në vendet më të mëdha dhe më të përparuar demokratike.

Le ta fillojmë duke u ndalur te tri vendet skandinave, të cilave iu referua fare kalimthi Kryeministri Rama. Është e vërtetë që atje, falë kontributit të tyre përcaktues për shtetin social dhe socializmin

” sui generis” skandinav, partitë social – demokrate atje kanë ” bërë ligjin” gjatë shekullit të kaluar dhe në vijim.

Megjithatë, dhe atje, fakt është se në të tria vendet skandinave, partitë social-demokrate vetëm se kanë dalë të parat, por ato nuk kanë fituar as dhe njëherë të vetme shumicën absolute si PS-ja jonë. Herë herë i janë afruar, në raste të tjera kanë fituar vetëm 1/3 dhe ¼ e vendeve në Parlament. Për rrjedhojë, ato kanë qenë të detyruara të qeverisin vazhdimisht me 2 – 3 partnerë të tjerë në koalicionet qeveritare. Më konkretisht, në Norvegji, laburistët drejtojnë aktualisht një qeveri pakice; madje, ndonëse kanë qenë të parat, meqenëse nuk kanë krijuar dot

koalicione me të tjerët, pas vitit 1945 dhe sidomos në dy dekadat e fundit kanë kaluar në shumë raste në opozitë. Ndërkohë, në Danimarkë, pas vitit 2000 erdhën në pushtet të djathtët e moderuar dhe këto 10 vitet e fundit të parët janë sërish social-demokratët; por, duke mos patur shumicë abosulte, dhe ata kanë hyrë në koalicion me tre parti të tjera. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me social-demokratët suedezë, të cilët vetëm njëherë, në vitin 1968 kanë fituar shumicën absolute, ndërsa në të gjitha rastet e tjera kanë qenë të parët por pa shumicën absolute.

Pra, siç shihet, ka një dallim të madh midis tyre dhe PS-së sonë, e cila ka 8 vjet që qeveris e vetme, rehat, madje si askund gjatë me shumicë më të madhe se në mandatin e kaluar, edhe pse treguesit social – ekonomikë kanë pësuar rënie. Vlen për t'u theksuar se ndonëse në vend të parë, përqindja e tyre ka ardhur në rënie, duke shkuar në favor të së djathtës ekstreme, e cila sidomos në vendet skandinave është “peshqesh” pikërisht nga e majta social-demokrate. Në zgjedhjet më të fundit të disa ditëve më parë, e djathta ekstreme në Norvegji kapi shifrën 24 për qind, vetëm 4 për qind më pak se social-demokratët, të cilët do vijojnë me qeveri pakice.

Ndërkohë, gjatë periudhës 2013 – 2025, në të tria vendet skandinave, ka patur 2, 3 dhe 4 kryeministra social-demokratë dhe të djathtës; edhe pse nuk mbahen mend për afëra/ skandale si te ne, por që i kalojnë me përgjegjësi personale.

Kjo tablllo rotacioni bëhet edhe më e qartë dhe shteruese kur kalojmë në kontinent dhe në SHBA. Në Gjermani, vetëm CDU-ja ka qëndruar dy herë 16 vite në

pushtet, me Adenauerin dhe Merkelin, dy liderë emblematicë europianistë të mëdhenj. Në Britaninë e Madhe po ashtu vetëm njëherë konservatorët ndenjen 18 vite (1979 – 1997) falë kryesisht Thatcherit dhe shembjes së komunizmit në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Nga partitë social-demokrate vetëm një herë PS-ja franceze qëndroi dhe ajo 16 vite në pushtet me Mitteranin emblematic, në Britani 12 vite me Blair/Gordon, ndërsa në Gjermani, Spanjë, Itali, asnjëherë më shumë se 7 vjet.

POR, ndryshe nga PS-ja jonë, gjatë këtyre periudhave, ato kanë qeverisur në koalicion me 2 ose dhe tre parti, siç po ndodh dhe tani me CDU-në dhe para një viti me SPD-në. Gjithashtu, ndryshe nga PS-ja që sa vjen dhe rritet, Adenauer, Merkel, Thatcher dhe Blair erdhën duke pësuar “firo” zgjedhore, derisa “u dorëzuan” pa asnjë skandal dhe në kohën e tyre më të mirë.

Rotacioni ka funksionuar mjaft mirë në demokracitë e Amerikës Latine dhe në SHBA me republikanët dhe demokratët, ku asnjëra nuk ka qeverisur me shuime se 10 vjet. Ndërsa presidentët atje dihet se qëndrojnë vetëm për dy mandate.

Vlen të theksohet se rotacionin politik në vendet me demokraci liberale e garantojnë dhe çimentojnë, krahas të tjerash zgjedhjet e lira dhe të ndershme; fatkeqësisht te ne ato nuk janë bërë ende realitet as në 35 vitet e fundit. Ndaj, traditat, mentaliteti dhe përvoja 150 vjeçare e demokracisë europiane dhe amerikane lidhur dhe me rotacionin dhe demokracinë në përgjithësi as që kanë të krahasuar me ne.

Natyrisht, përjashtim nga rotacioni bëjnë vendet autoritare, ku pushteti ashtu si revolucionin janë

të përhershëm dhe të përvetshëm, pa zgjedhje por me votime farsë. Ja pse, ta quash rotacionin politik “përrallë” kur ai është realitet kudo, po, dhe në vendet skandinave është kampioni e madhe alarmi për të gjithë, brenda dhe jashtë vendit, se demokracia pluraliste është në rrezik, duke dhënë të qartë të kuptohet se shumica e tanishme nuk e do rotacionin. Sepse le ta theksojmë, rotacioni nuk është fjalë goje dhe as përrallë, por shenja e madhe dalluese midis monizmit dhe pluripartizmit, midis diktaturës dhe demokracisë liberale. Po, pa këtë rotacion, gjithçka tjetër mund të kthehet në përrallë, jo si nga e kaluara te filmi, por shumë më keq se atë.

Ama ky rotacion realizohet jo me slogane, samite dhe parodi, por nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të cilat deri tani janë e munguara e madhe në Shqipëri. Ndryshe nuk do të ndodhte si në asnjë vend tjetër, që mandatin e katërt shumica të marrë dhe më shumë vende në parlament. Sepse pushteti të konsumon dhe të amortizon në demokraci. Sepse çdo alternativë dhe më e mira në dukje vjen një moment dhe shteron, ndaj duhen versione të reja. Por, nëse dikush i pengon ato shprehimisht me përrallën e rotacionit, të shoqëruar me lloj lloj trukesh dhe hilesh, atëherë ky është ogur i keq për demokracinë, e cila dallohet pikërisht nga pranimi i rotacionit, jo detyrimisht 4 vjet, por dhe më gjatë, por jo deri më 2040 apo ca më keq 2050. Pastaj, përse duhet ky futurizëm i kotë politik për vitin 2050, kur kemi përpara ende 2030? Gjithsdesi, besojmë se përjashtimi shqiptar nuk do të jetë i justifikuar, i besueshëm dhe as i realizueshëm. Ndryshe, vërtet që dhe te ne rotacioni politik do të bëhet “përrallë nga e kaluara”.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë dënon sulmin rus me dronë në territorin polak

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë dënon sulmet e rrezikshme ruse me dronë në territorin e Polonisë, sulme që çënojnë hapur sovranitetin teritorial të një vendi anëtar të OKB, NATO-s, BE etj.

Ky sulm ushtarak rus në një prej vendeve të rëndësishme evropiane, i cili e ka dënuar me force agresionin rus kundër Ukrainës, të një vendi që jep kontribute të rëndësishme për forcimin e paqes dhe sigurisë në Evropë e më gjerë, dëshmon faktin se politika ruse e agresionit, e destabilitetit dhe e konfliktit mund të përshkallëzohet dhe të rrezikojë sigurinë dhe stabilitetin në pjesë të tjera të kontinentit tonë e me gjerë.

Ndaj këto tentativa për përshkallëzim duhet të ndalohen me çdo kusht, ashtu siç duhet detyruar Federata Ruse të ndërpresë sa më parë luftimet në Ukrainë, të tërhiqet nga të gjitha territoret e pushtuara të atij vendi dhe të mbahet përgjegjëse për dëmet e shkaktuara në njerëz dhe infrastrukturë. Vetëm kështu mund të arihet një paqe e qëndrueshme në Ukrainë dhe të ndalohet çdo tentativa ruse për përsëritje skenarësh, si ai i Ukrainës, në vende të tjera.

KASH nxit politikën shqiptare dhe i bën thirrje të gjitha ven-



KASH nxit politikën shqiptare dhe i bën thirrje të gjitha vendeve anëtare të NATO-s e BE që të shprehin solidaritet të plotë me Poloninë, vendet balltike, por edhe vende të tjera në kufi me Ukrainën që janë dëmtuar nga inkursionet e herë pas herë ushtarake ruse, të forcojnë unitetin midis tyre dhe të rrisin gadishmërinë ushtarake për tui kundërvënë çdo provokacioni të rrezikshëm rus që dëmton paqen dhe stabilitetin në kontinent e më gjerë.

deve anëtare të NATO-s e BE që të shprehin solidaritet të plotë me Poloninë, vendet balltike, por edhe vende të tjera në kufi me Ukrainën që janë dëmtuar nga inkursionet e herë pas herë ushtarake ruse, të forcojnë unitetin midis tyre dhe të rrisin gadishmërinë ushtarake për tui kundërvënë çdo provokacioni të rrezikshëm rus që dëmton paqen dhe stabilitetin në kontinent e më

gjerë.

Ukraina, si një vend me vlera në kontinent, që po përballon me vendosmëri agresionin e pa provokuar rus dhe që po lufton në vijën e parë të frontit kundër këtij kundërvënësi të paqes e njerëzimit, duhet mbështetur pa rezerva se vendosja e paqes dhe sigurisë në Ukrainë do të thotë ruajtje dhe forcim i paqes në të gjithë kontinentin tonë, por edhe në botë.

SHBA propozon planin e paqes në Gaza, përfundim i luftës dhe kthim i pengjeve



Donald Trump dhe Benjamin Netanyahu, kryeministri izraelit, i kanë dhënë një ultimatum Hamasit, duke e paralajmëruar grupin militant të pranojë planin e tyre të paqes me 20 pika për Gazën ose të përballlet me pasojat.

Të dy udhëheqësit u takuan në Shtëpinë e Bardhë në Uashington të hënën dhe më pas mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp, në të cilën e përshëndetën propozimin e tyre si një përparim historik dhe një kapitull të ri për Lindjen e Mesme.

Por ishte e qartë se Hamasi nuk ishte konsultuar dhe qëndrimi i tij mbi kushtet mbeti i pasigurt. Mahmoud Mardawi, një zyrtar i Hamasit, tha se grupi as nuk e kishte marrë planin në kohën e

njoftimit, raportoi agjencia e lajmeve Reuters. Më vonë u informua se ndërmjetësit e Katarit dhe Egjiptit u takuan me Hamasin të hënën në mbrëmje për t'i ofruar grupit planin e paqes.

Si Trump ashtu edhe Netanyahu e bënë të qartë se nuk po i ofronin Hamasit një zgjedhje në këtë çështje. Nëse grupi do të refuzonte, Trump u tha gazetarëve, “Izraeli do të kishte mbështetjen

time të plotë për të përfunduar punën e shkatërrimit të kërcënimit të Hamasit.

“Por shpresoj se do të kemi një marrëveshje për paqe, dhe nëse Hamasi e refuzon marrëveshjen... Bibi, do të kesh mbështetjen tonë të plotë për të bërë atë që do të duhej të bëjë.”

Kryeministri izraelit tha me zymtësi: “Nëse Hamasi e refuzon planin tënd, z. President,

“

Si Trump ashtu edhe Netanyahu e bënë të qartë se nuk po i ofronin Hamasit një zgjedhje në këtë çështje. Nëse grupi do të refuzonte, Trump u tha gazetarëve, “Izraeli do të kishte mbështetjen time të plotë për të përfunduar punën e shkatërrimit të kërcënimit të Hamasit.

ose nëse supozohet se e pranon atë dhe pastaj bën gjithçka për ta kundërshtuar, atëherë Izraeli do ta përfundojë punën vetë. Kjo mund të bëhet në mënyrën e lehtë ose mund të bëhet në mënyrën e vështirë, por do të bëhet.”

Netanyahu shtoi: “Ne do të preferonim rrugën e lehtë, por duhet bërë. Të gjitha këto qëllime duhet të arrihen sepse ne nuk e luftuam këtë luftë të tmerrshme, nuk sakrifikuam më të mirët e të rinjve tanë që Hamasi të qëndronte në Gaza dhe të na kërcënonim përsëri e përsëri me këto masakra të tmerrshme.”

Asnjëri prej tyre nuk iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve. Më parë, Shtëpia e Bardhë publikoi planin 20-pikësh që synonte t’i jepte fund luftës në territorin palestinez që shpërtheu pas sulmit vdekjeprurës më 7 tetor 2023.

Ai kërkon një armëpushim, një shkëmbim të pengjeve të mbajtura nga Hamasi me të burgosurit palestinezë të mbajtur nga Izraeli, një tërheqje të organizuar të Izraelit nga territori palestinez, çarmatim të Hamasit dhe një qeveri kalimtare të udhëhequr nga një organ ndërkombëtar.

Trump tha: “Nëse pranohet nga Hamasi, ky propozim kërkon lirin e të gjithë pengjeve të mbetura menjëherë, por në asnjë rast më shumë se 72 orë... Pengjet po kthehen.”

Plani kërkon gjithashtu që Hamasi të lërë armët dhe të heqë dorë nga qeverisja në Rrip. Anëtarëve të Hamasit që angazhohen për bashkëjetesë paqësore do t’u jepet amnisti për të qëndruar në Gaza ose do t’u jepet kalim i sigurt në vendet pritëse.

Plani i Trump do të krijojë gjithashtu një bord qeverisës të përkohshëm që do të drejtohet



DONALD TRUM

“Izraeli do të kishte mbështetjen time të plotë për të përfunduar punën e shkatërrimit të kërcënimit të Hamasit. “Por shpresoj se do të kemi një marrëveshje për paqe, dhe nëse Hamasi e refuzon marrëveshjen... Bibi, do të kesh mbështetjen tonë të plotë për të bërë atë që do të duhej të bëje.”



nga vetë Trump dhe do të përfshijë Tony Blair, ish-kryeministrin britanik.

Trump tha: “Për të siguruar suksesin e kësaj përpjekjeje, plani im kërkon një organ të ri mbikëqyrës ndërkombëtar – Bordin e Paqes – i cili do të drejtohet, jo me kërkesën time... nga një zotëri i njohur si Presidenti Donald J. Trump i Shteteve të Bashkuara.” Plani 20-pikësh i së hënës thotë se “një plan zhvillimi ekonomik i Trump për të rindërtuar dhe fuqizuar Gazën do të krijohet duke mbledhur një panel ekspertësh që kanë ndihmuar në lindjen e disa prej qyteteve moderne mrekullibërëse në Lindjen e Mesme”.

Por ai gjithashtu vëren: “Askush nuk do të detyrohet të largohet nga Gaza, dhe ata që dëshirojnë të largohen do të jenë të lirë ta bëjnë këtë dhe të lirë të kthehen”.



Benjamin Netanyahu

“Nëse Hamasi e refuzon planin tënd, z. President, ose nëse supozohet se e pranon atë dhe pastaj bën gjithçka për ta kundërshtuar, atëherë Izraeli do ta përfundojë punën vetë. Kjo mund të bëhet në mënyrën e lehtë ose mund të bëhet në mënyrën e vështirë, por do të bëhet.”



Në konferencën e përbashkët për shtyp në sallën e ngrënies shtetërore, në një sfond me flamuj amerikanë dhe izraelitë, Trump tha se ata ishin “shumë afër” arritjes së marrëveshjes së pakapshme të paqes dhe se shpresonte që edhe militantët e Hamasit ta pranonin atë.

“Nuk kemi mbaruar plotësisht. Duhet ta marrim Hamasin, por mendoj se ata do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë. Pra, tani është koha që Hamasi të pranojë kushtet e planit që kemi paraqitur sot”.

Trump shtoi: “Dua gjithashtu të falënderoj Kryeministrin Netanyahu që ra dakord për planin dhe për besimin se nëse punojmë së bashku, mund t’i japim fund vdekjes dhe shkatërrimit që kemi parë për kaq shumë vite, dekada, madje shekuj dhe të fillojmë një kapitull të ri sigurie, paqeje dhe prosperiteti për të gjithë rajonin.”

Në vizitën e katërt të Netanyahu në Shtëpinë e Bardhë që kur Trump u rikthye në detyrë në janar, udhëheqësi i krahut të djathtë izraelit po kërkonte të forconte marrëdhënien më të rëndësishme të vendit të tij, pasi një mori udhëheqësish perëndimorë përqaftuan zyrtarisht shtetësinë palestineze javën e kaluar në kundërshtim me SHBA-në dhe Izraelin.

Trump, i cili kritikoi ashpër lëvizjet e njohjes si një çmim për Hamasin, po kërkonte marrëveshjen e Netanyahu pavarësisht dyshimeve të Izraelit për disa pjesë të planit.

Uashingtoni ia paraqiti planin e tij të paqes shteteve arabe dhe muslimane në margjinat e asamblesë së përgjithshme të OKB-së javën e kaluar, dhe objektivi kryesor i Trump të hënën ishte të përpiquej të mbyllte boshllëqet e mbetura me Netanyahu. Ai dukej se ia kishte dalë mbanë.

Netanyahu, i cili ka një urdhër arresti nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC) kundër tij për krime të dyshuara, përfshirë urinë si metodë lufte, përdori platformën e Shtëpisë së Bardhë për të lëvduar Trumpin dhe për të renditur kërkesat e tij.

“Unë mbështes planin tuaj për t’i dhënë fund luftës në Gaza, i cili arrin qëllimet tona të luftës”, tha ai. “Do t’i kthejë Izraelit të gjithë pengjet tona, do të çmontojë aftësitë ushtarake të Hamasit, do t’i japë fund sundimit të tij politik dhe do të sigurojë që Gaza të mos përbëjë më kurrë një kërcënim për Izraelin.”

Ai shtoi: “Hamasi do të çarmatoset. Gaza do të çmilitarizohet. Izraeli do të mbajë përgjegjësinë e sigurisë, duke përfshirë një perimetër sigurie, për të ardhmen e parashikueshme. Dhe

“Si hap i parë, Kryeministri Netanyahu shprehu keqardhjen e tij të thellë që sulmi me raketa i Izraelit kundër objektivave të Hamasit në Katar vrau pa dashje një ushtar të Katarit”, tha Shtëpia e Bardhë në një deklaratë. “Ai shprehu më tej keqardhjen që, duke synuar udhëheqjen e Hamasit gjatë negociatave për pengje, Izraeli shkeli sovranitetin e Katarit dhe pohoi se Izraeli nuk do të kryejë përsëri një sulm të tillë në të ardhmen.”

së fundmi, Gaza do të ketë një administratë paqësore dhe civile që nuk drejtohet as nga Hamasi dhe as nga Autoriteti Palestinez.”

Por mungesa e dukshme e Hamasit nga negociatat ka ngritur pyetje në lidhje me perspektivat e iniciativës së fundit.

Në një deklaratë të hënën vonë, Blair tha: “Presidenti Trump ka hartuar një plan të guximshëm dhe inteligjent i cili, nëse miratohet, mund t’i japë fund luftës, të sjellë lehtësim të menjëhershëm në Gaza, mundësinë për një të ardhme më të ndritur dhe më të mirë për popullin e saj, duke siguruar njëkohësisht sigurinë absolute dhe të qëndrueshme të Izraelit dhe lirimin e të gjithë pengjeve.

“Kjo na ofron mundësinë më të mirë për t’i dhënë fund dy viteve luftë, mjerim dhe vuajtje, dhe e

falënderoj Presidentin Trump për lidhshërinë, vendosmërinë dhe angazhimin e tij.”

Më parë, Netanyahu i kërkoj falje zyrtare homologut të tij nga Katar për një sulm të kohëve të fundit ushtarak që synonte zyrtarët e Hamasit në Emiratit e Gjirit, i cili zemëroi udhëheqësit arabë dhe shkaktoi kritika të rralla nga SHBA-të ndaj Izraelit.

Netanyahu i bëri telefonatën kryeministrit të Katarit, Sheikh Mohammed bin Abdulrahman al-Thani, ndërsa ai u takua me Trump, sipas Shtëpisë së Bardhë. Trump e përshkroi shkëmbimin mes liderit izraelit dhe atij të Katarit si një thirrje “zemër-mezemër”.

“Si hap i parë, Kryeministri Netanyahu shprehu keqardhjen e tij të thellë që sulmi me raketa i Izraelit kundër objektivave të Hamasit në Katar vrau pa dashje një ushtar të Katarit”, tha Shtëpia e Bardhë në një deklaratë. “Ai shprehu më tej keqardhjen që, duke synuar udhëheqjen e Hamasit gjatë negociatave për pengje, Izraeli shkeli sovranitetin e Katarit dhe pohoi se Izraeli nuk do të kryejë përsëri një sulm të tillë në të ardhmen.”

Netanyahu shtoi para gazetarëve: “Izraeli po synonte terroristët, nuk po synonte Katarin dhe sigurisht që na erdhi keq për humbjen e qytetarit të Katarit i cili nuk ishte objektivi ynë.”

Vonën e së hënës, ministrat e jashtëm të Arabisë Saudite, Jordanisë, Emirateve të Bashkuara Arabe, Katarit dhe Egjiptit e mirëpritën njoftimin e Trump në një deklaratë të përbashkët.

Propozimi u mirëprit edhe nga Autoriteti Palestinez, i cili tha se mbështeste “përpjekjet e vendosura” të Trump për t’i dhënë fund luftës.

ELEFANTI NË DHOMË



Ditmir Bushati

Palestina do të jetë “elefanti në dhomë”, gjatë takimit vjetor të Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që nis këtë javë. Disa shtete të mëdha perëndimore si Mbretëria e Bashkuar, Franca, Kanadaja, Australia, Zelanda e Re lajmëruan njohjen e saj. Të njëjtën gjë po bëjnë edhe Portugalia, Belgjika, Luksemburgu, Malta, San Marino dhe Andorra.

Deri më tani shtetësia palestineze është një prej çështjeve më të debatuar në OKB. Palestina gëzon njohje ndërkombëtare prej më shumë se gjysmës së vendeve

anëtare të OKB-së, gjë që i lejon asaj të mbajë misione diplomatike jashtë vendit dhe të marrë pjesë pjesërisht, si shtet vëzhgues, në OKB. Megjithatë, asaj i mungojnë kufijtë e sanksionuar nga rezoluta e OKB-së e vitit 1948, një ushtri, një kryeqytet dhe sovranitet i plotë për shkak të konfliktit të vazhdueshëm me Izraelin.

Pse këto njohje tani?

Të gjitha këto vende historikisht kanë treguar mbështetje të fortë për Izraelin. Madje, një dekadë më parë, asnjë prej këtyre shteteve nuk votoi në mbështetje të statusit të vëzhguesit të Palestinës në OKB. Por skenat e urisë në Gaza dhe zemërimi në rritje për egërsinë e fushatës jop-

roporcionale ushtarake të Izraelit në përgjigje të sulmeve terroriste të 7 tetorit të Hamasit, kanë ndryshuar opinionin publik në shumë prej këtyre vendeve.

A do ta ndryshojnë këto njohje situatën në terren?

E vështirë. Gjithsesi, fakti që vendet e fuqishme të G7-ës e ndërmarrin këtë hap për herë të parë sinjalizon një ndryshim të valës në Perëndim, veçanërisht midis disa prej mbështetësve më të vendosur të Izraelit. Kjo gjithashtu i jep Palestinës mbështetjen e katër prej pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Njohja e Palestinës nga këto shtete argumentohet me “riafirmimin e të drejtës së popul-

lit palestinez për vetëvendosje” dhe si kontribut për një zgjidhje me dy shtete. Ndërkohë që mbështetësit e Izraelit argumentojnë se zgjidhja me dy shtete nuk mund të vijë si shpërblim ndaj Hamasit, dhe pa zhdukjen e plotë të tij nuk mund të ketë as armëpushim e as dialog që i prin një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe përfundimtare.

Po ne?

Megjithëse e ka njohur shtetin e Palestinës në vitin 1988, kur Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2012 votoi për t’i dhënë Palestinës statusin e shtetit vëzhgues jo-anëtar, Shqipëria abstenoj. Në vitin 2018, Shqipëria votoi në mbështetje të rezolutës që hidhte poshtë vendimin për të njohur Jeruzalemin si kryeqytet të Izraelit. Gjatë përkallëzimit të luftës në Gaza, qëndrimi i Shqipërisë u bë edhe më i paqartë duke reflektuar mungesë koherence në votimet në OKB, dhe ç’është më e keqja, mungesë ndjeshmërie ndaj disa parimeve të cilat Shqipëria i ka promovuar për shkak të historisë së popullit shqiptar.

Në maj dhe shtator të vitit 2024, kur Asambleja e Përgjithshme miratoi rezoluta për pranimin e Palestinës si anëtare me të drejta të plota, Shqipëria sërish abstenoj. Shqipëria nuk mbështeti deklaratën e New York që doli nga punimet e Konferencës së Nivelit të Lartë dhe abstenoj për rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të 12 shtatorit 2025 që mbështet zgjidhjen me dy shtete (Izrael/Palesintë). Madje, Shqipëria abstenoj edhe në votimin e rezolutës të 19 shtatorit 2025, për pjesëmarrjen e



Palestinës në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së të këtij viti.

Vota abstenuese në kushtet kur Shqipëria e njeh Palestinën, dhe është shprehur vijimësisht se mbështet një zgjidhje me dy shtete, përforcon perceptimin e një politike të jashtme kameleonike, nën diktatin e bursës së politikës së brendshme.

Një nga sfidat e politikës së jashtme është koherenca dhe qëndrueshmëria në raport me parimet që mbrojmë dhe interesat që kemi, duke ruajtur njëkohësisht aleancat me partnerët strategjikë. Kjo kthehet në domosdoshmëri, sidomos në një kohë të pasigurtë kur referencat ndryshojnë vazhdimisht. Ndërsa objektivat dhe aspiratat tona përbëjnë horizontin e politikës së jashtme, parimet dhe qëndrueshmëria e orientimeve tona duhet të jenë vija kufizuese e përcaktuese të horizontit.

Të kuptohemi, Shqipëria është

një vend i vogël që nuk ka në dorë zgjidhjen e konflikteve të ndërlikuara. Por që të veprojmë me seriozitet dhe të demonstrojmë qartësi strategjike është detyrimi ynë. Të tilla çështje kërkojnë drejtpeshimin e interesave dhe parimeve që kemi promovuar ndër vite, pasi në lojë është pjekuria dhe vazhdimësia e shtetit, aftësia për t’u orientuar siç duhet në një botë që ndryshon vazhdimisht.

Dënimi pa asnjë mëdyshje i veprimeve terroriste të Hamasit, respekti për civilët e pafajshëm, parimet dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare të shpërfillura në katastrofën humanitare në Gaza, dhe një riafirmim i një zgjidhjeje me dy shtete Izrael/Palestinë, do të ishte një qëndrim i drejtë, i moralshëm, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. E në të njëjtën kohë, në respekt të historisë sonë me hebrenjtë e strehuar në Shqipëri gjatë nazizmit dhe partneritetit të farkëtuar ndër vite me shtetin e Izraelit.

Kthesë apo thikë me dy presa?! Stuhia palestineze në Nju Jork! Sa ndryshime në krye të diplomacisë

REAL POLITIK NR. 114 | 10 - 28 SHTATOR 2025 | EKSLUZIVE PËR ARGUMENTUM

Komente "flash" mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur, Mjeshtër i Madh në Diplomaci

DR. JORGJI KOTE GRAND MASTER

1.

Pompë, bujë dhe bukë! Kështu mund të përmblihet vizita shtetërore e Presidentit Trump në Britaninë e Madhe me ftesë të Mbretit Charles më 17 Shtator. Diçka unike në protokollin diplomatik që një Kryetar Shteti e sidomos ai amerikan bën në Londër dy vizita shtetërore brenda 5 viteve. Kjo u bë në kuadrin e demarsheve diplomatike europiane dhe londoneze për ta marrë me të mirë Presidentin Trump. Dihet se ftesa për këtë vizitë ishte edhe hyrja e suksesshme e Kryeministrit Keir Starmer gjatë takimit me Trump në Shtëpinë e Bardhë disa muaj më parë. Vizita e Trump ishte në traditën më të mirë të monarkisë britanike, që ai e ka shumë për zemër. Kjo vizitë ishte kartolinë, mesazh dhe imazh pozitiv për opinionin brenda SHBA-ve dhe në Europë. Pas Samitit në Shtëpinë e Bardhë më 18 Gusht, kjo ishte lëvizja e dytë madhore e mençur diplomacinë europiane për ta mbajtur Trumpin « on board» lidhur me angazhimin e tij ndaj Ukrainës dhe korrigjimin e qëndrimit ndaj Rusisë. Këtë ia tha me një frazë vlerësuese Mbreti Charles gjatë banketit mbretëror dhe Kryeministri Starmer gjatë takimit të tyre. Natyrisht nuk mund të pritët mrekulli nga Trump, por duket se



efektet e asaj vizite u ndjenë dhe në kthesën e tij, ndonëse retorike dhe dyshuese në Nju Jork më 23 Shtator kur deklaroi se Ukraina mund t'i rimarrë territoret e humbura me ndihmën e Europës dhe të NATO-s.

2.

Kthesë apo thikë me dy presa? Kjo është pyetja që bëhet pas deklaratës së mësipërme të Presidentit Trump në Nju Jork dhe në takimin me Presidentin Zelenski. Krejt ndryshe nga deri tani, Trump bëri pohimin e mësipërm, madje duke shtuar se Rusia është « tigër prej letre që po bën një luftë pa qëllim dhe pa kuptim!» Por, Presidenti Putin nuk e ka marrë seriozisht as këtë radhë Trumpin; madje vuri zëdhënësin e tij Pescov që ta përgënjeshtrointe atë, duke thënë se Rusia nuk është tigër, ca me pak prej letre por ari dhe se do të vazhdojë të luftojë

për të realizuar qëllimet e saj të shpallura në frontin e luftës. Kjo dhe sepse siç ka treguar deri tani, Trump i ngjan një lavjerësi politik, ai çfarë thotë sot nuk e thotë nesër !! Në fakt me këtë kthesë 180 gradë, Trump fiton pikë në botë në favor të imazhit të tij dhe të Amerikës; mirëpo, ndërkohë, duke mos e përmendur kontributin direkt të SHBA-ve në Ukrainë, ai e qetëson bazën e MAGA, e cila është kundër rolit të SHBA-ve si polic ndërkombëtar të SHBA-ve. Gjithashtu, në kuadrin e doktrinës së tij transaksionaliste, të mbështetur në ujdë tregtare fitimprurëse, Trump beson se kështu do të fitojë më shumë falë shtimit të shitjeve të armatimit modern të Europa dhe NATO, për t'ia dhënë Ukrainës.

Në fakt, liderët europianë nuk e kanë përshëndetur këtë kthesë 180 gradë, siç thuhet të Presidentit Trump dhe kjo lidhet me

dyshimin e tyre se Trump po mundohet të heqë dorë nga angazhimi amerikan në Ukrainë, për t'ia lënë këtë “dopio gjashtë gjeopolitike” në dorë Europës dhe NATOS. Kështu, nga pretendimi i tij për të qenë ujdibërës “brenda natës” Presidenti Trump do që të jetë spektator i luftës në Ukrainë. Ndaj kjo shihet si “thikë me dy presa”!

3.

Stuhia palestineze në OKB! Ash-tu siç përmendej në rubrikën e kaluar «Një vjeshtë me stuhi në Nju Jork» ndodhi më 22 – 27 Shtator në sesionin e 80-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Presidenti Macron dhe liderët e Kanadasë, Britanisë së Madhe, Belgjikës, Australisë, Luksemburgut dhe të tjerë shpallën botërisht njohjen e shtetit të Palestinës. Sepse sipas tyre tani dhe jo nesër është momenti më i duhur dhe që po kërkohet gjithandej. Si një proces me disa hapa që përfshin tërheqjen e Izraelit nga Gaza, çar-matosjen e Hamasit dhe largimin e tij nga politika, reformimin e Autoritetit Palestinez që të marrë në dorë edhe administrimin e Gazës dhe paqe të qëndrueshme. Por, këto të fillojnë me njohjen e shtetit të Palestinës. SHBA-të dhe Izraeli e kundërshtojnë kategorikisht duke e quajtur shpërbllim për



Hamasin dhe duke parashtruar Planin amerikan me 21 pika. Pavarësisht nga kjo stuhia e fuqishme diplomatike, njohja e shtetit të Palestinës është shumë larg, për të mos thënë e pamundur, përderisa SHBA-të janë kundër; por ajo është veprimi i drejtë në çdo pikpamje dhe pasqyron protestat masive kudo në botë në



mbështetje të Palestinës dhe denoncim i dhunës së pashëmbullit në Gaza.

4.

Sa shumë ndryshime janë bërë kohët e fundit në krye të diplomacisë sonë! Jemi vërtet rast «sui generis» për numrin e madh të ministrave të jashtëm gjatë



25 viteve të fundit krahasuar me vendet e tjera demokratike. Më konkretisht, ish Ministri i Jashtëm, Igli Hasani nuk i bëri dot as dy vjet në detyrë. Ai ishte ministri i 6-të i Jashtëm që ndryshon brenda 12 viteve të fundit, dmth një në çdo dy vjet. Kur normalisht sidomos kryediplomatët qëndrojnë të paktën 4 vjet, madje dhe më shumë. Emblematicu gjerman Genscher ndenji plot 15 vjet në dy koalicione të ndryshme partiake, madje e dha dorëheqjen në kulmin e suksesit, për t'i hapur rrugën më të rinjve pas epokës së re pas shembjes së Murit të Berlinit. Pasardhësit e ti qëndruan të paktën 7 vjet, se e tilë është natyra e veçantë e diplomacisë.

Pas normalitetit në vitet 1992 – 2002 me 2 ministra me mandat të plotë, në 24 vitet e fundit kemi patur 15 ministra të jashtëm, mesatarisht një në më pak se dy vjet! Gjatë 20 viteve të fundit të shërbimit tim diplomatik janë ndryshuar 11 kryediplomatë! Bashkë me ta kabinetet, këshilltarët, drejtorët, letrat deri në përfaqsitë tona diplomatike. Dhe, me ndonjë përjashtim, ministrat kanë lëvizur në kulmin e suksesit diplomatik të vendit dhe të tyre personalisht. Kështu, Igli Hasani ishte ambasador në Vjenë kur kryesuam me sukses OSBE-në më 2020, ai ishte ministër gjatë anëtarësimit dhe kryesimit tonë të KS të OKB-së, kur Tirana mikprititi disa samite të rëndësishme europiane dhe mbi të gjitha u çelën negociatat me BE-në. Ndaj dhe kritikata e Kryeministrit për diplomacinë tonë se punoka me orar tjetër, kur Ministrin e vlerëson tejet të suksesshëm duket e paqartë dhe e çuditshme. Këtej mburremi me arritjet tona gjeopolitike, andej qortojmë shërbimin tonë diplomatik. Paradoks i vërtetë!

“SHQIPËRIA 2030 NË BE”

Fjalimi i Kryeministrit Rama në hapjen e legjislaturës së re

Kryeministri Edi Rama prezantoi para Kuvendit programin qeverisës për katër vitet e ardhshme, duke e cilësuar këtë mandat të katërt si një nga sfidat më të mëdha që ka përballuar ndonjëherë qeverisja shqiptare. Fjalimi i tij u përqendrua në disa shtylla kyçe: përgjegjësia ndaj qytetarëve pas një fitoreje të thellë zgjedhore, sfida historike e anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe roli strategjik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në modernizimin e shtetit.

“Ky mandat i ri është provimi ynë i madh i shtetit,” deklaroi Kryeministri, duke e krahasuar përgjegjësinë e shumicës së re me një test kombëtar që përkon në kohë dhe rëndësi me planin e integritimit europian. Sipas tij, përmbushja e këtij objekti madhor do të varet jo vetëm nga programi i shkruar, por nga angazhimi real dhe transformimi i çdo premtimi në rezultate të prekshme për qytetarët.

“Kohëzgjatja e këtij provimi përkon me kohëzgjatjen e planit ambicioz kombëtar për të ulur Shqipërinë në tryezën e familjes së bashkuar europiane,” tha Rama, duke shtuar më tej: “Programi ynë i ri qeverisës është fletorja e zgjidhjeve të provimit, por suksesi i këtij provimi historik



do të varet i gjithi nga aftësitë e secilit dhe secilës dhe këmbëngulja jonë e përbashkët për t'i kaluar zgjidhjet nga letra e programit në realitetin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve.”

Kryeministri nënvizoi se “Shqipëria 2030 në BE” është jo vetëm vizioni udhëheqës i qeverisë, por edhe pika e referencës për çdo vendimmarrje politike e institucionale gjatë këtij mandati. “Shqipëria Europiane është busulla orientuese e çdo faqeje të programit tonë dhe metronomi i ritmit të çdo reforme që do të ndërmerim,” deklaroi ai, duke i dhënë procesit të integritimit një dimension strategjik dhe të pandarë nga

politika e brendshme.

Në vijim të fjalës, Rama vuri theksin tek inovacioni dhe inteligjencia artificiale si dy nga shtyllat e reja të modelit qeverisës. Ai njoftoi për krijimin e një pozicioni të ri ministror – Ministrja e Shtetit për Inteligjencën Artificiale – që do të drejtohet nga Diella, si dhe për ngritjen e një akseleratori inovacioni, me emrin AI4 – Albanian Innovation 4, që do të ketë misionin të transformojë administratën, të përshpejtojë digjitalizimin dhe të lidhë më ngushtë shërbimin publik me sipërmarrjen teknologjike.

Rama e përshkroi këtë qasje si një mënyrë të re për të ndërtuar shtet në epokën digjitale dhe

për të pozicionuar Shqipërinë si një vend që jo vetëm ndjek zhvillimet globale, por synon të jetë pararojë në rajon për përdorimin strategjik të teknologjisë në shërbim të qytetarëve dhe qeverisjes së mirë.

PARLAMENT, FJALA E KRYEMINISTRIT EDI RAMA
I nderuar Kuvend i Shqipërisë!
Të nderuar miq dhe të ftuar!

Lejomëni në fillim që si folës i parë i kësaj legjislature të re, në këtë pjesë vendimtare të rrugës së Shqipërisë europiane të përcjell urimin tim për një drejtim sa më të suksesshëm të punëve të Kuvendit, Kryetarit të ri të Kuvendit Niko Peleshi. Urime dhe suksese!

Unë nuk jam këtu sot për të kryer një formalitet votë besimi të qeverisë së re me mbështetjen aritmetike të një shumice të pazakonshme në këtë sallë dhe dua t'i them pikërisht shumicës, se jo një mandat, por vite të tëra politike nuk mjaftojnë për ta shpërblyer besimin e jashtëzakonshëm që shqiptarët na dhanë këtë herë. 83 mandate apo mbi 50% e zgjedhësve në mbështetjen tonë janë shifra të një borxhi të jashtëzakonshëm për mandatin e katërt radhazi. Është një borxh që duhet ta marrim përsipër çdo ditë, jo me fjalë, por me një vijë të re sjelljeje, me një qasje të re vetëkritike, me ide dhe risi në çdo drejtim, me durim, me vullnet, me përkushtim dhe me energji të reja në çdo hap për suksesin e këtij mandati të ri.

Ndërsa pakicës dua t'i them vetëm se nuk është puna jonë çfarë bëni dhe çfarë thoni jashtë kësaj sale, por në këtë sallë dhe në respekt të zgjedhësve tuaj, do të keni të gjithë vëmendjen tonë dhe të gjithë kohën që të

Unë nuk jam këtu sot për të kryer një formalitet votë besimi të qeverisë së re me mbështetjen aritmetike të një shumice të pazakonshme në këtë sallë dhe dua t'i them pikërisht shumicës, se jo një mandat, por vite të tëra politike nuk mjaftojnë për ta shpërblyer besimin e jashtëzakonshëm që shqiptarët na dhanë këtë herë. 83 mandate apo mbi 50% e zgjedhësve në mbështetjen tonë janë shifra të një borxhi të jashtëzakonshëm për mandatin e katërt radhazi.

dëshironi nëse do të harroni përdorimin e trupit, të duarve, të këmbëve si argument dhe të zhurmës dhe të rënies me dorë të tavolinave si alternativë. Në të kundërt prania jonë këtu do të zgjasë sa një proces votimi. Mbaseni parasysh këtë!

Ky mandat i ri është provimi ynë i madh i shtetit. Kohëzgjatja e këtij provimi përkon me kohëzgjatjen e planit ambicioz kombëtar për të ulur Shqipërinë në tryezën e familjes së bashkuar europiane. Dhe programi ynë i ri qeverisës është fletorja e zgjidhjeve të provimit, por suksesi i këtij provimi historik do të varet i gjithi nga aftësitë e secilit dhe secilës dhe këmbëngulja jonë e përbashkët për t'i kaluar

zgjidhjet nga letra e programit në realitetin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

Shqipëria 2030 në BE është kryefjala e këtij mandati. Shqipëria europiane është busulla orientuese e çdo faqeje të programit tonë dhe metronomi i ritmit të çdo reforme që do ndërmarrim. Si zakonisht edhe në tre herë e shkuara në një seancë si kjo, unë as nuk do lexoj të gjithë programin, që e keni të gjithë në dispozicion, as nuk do të marr kohën e kuvendit apo rolin e çdo ministri duke i prekur në detaje të gjitha fushat të cilat ministrat do t'i paraqesin një dhe nga një. Prandaj pjesën më të madhe të kësaj fjale do ta zërë inovacioni dhe intelijenca artificiale si dy





kuaj të një rëndësie strategjike të betejave tona për Shqipërinë 2030.

Shteti i së drejtës është themeli i anëtarësimit në familjen e bashkuar europiane. Udhë është pa kthim. Konsolidimi i pavarësisë të gjyqësorit është thelbësor. Kodi i ri Penal, kodi i ri i procedurës penale dhe Kodi i ri Civil janë në proces si baza të reja të një legjislacioni modern me standardet më të larta europiane. Nga ana tjetër, revolucioni digjital do të shtrihet më tej edhe në fushën e drejtësisë dhe të ligjzbatimit në tërësi për të ndihmuar nga njëra anë eficienten, transparencën, llogaridhënien e institucioneve demokratike dhe nga ana tjetër forcimin e lirive dhe të



Shqipëria është i vetmi vend në rajon që përdor me shumë sukses inteligjencën artificiale për të përshpejtuar e legjislacionit me BE. Futja e inteligjencës artificiale në shërbim të mirëqeverisjes, të anti korrupsionit dhe të progresit të përshpejtuar social ekonomik do të jetë një prioritet i pa ndarë i të gjitha ministrive dhe agjencive të vendit.



drejtave të individit.

Shqipëria është i vetmi vend në rajon që përdor me shumë sukses inteligjencën artificiale për të përshpejtuar e legjislacionit me BE. Futja e inteligjencës artificiale në shërbim të mirëqeverisjes, të anti korrupsionit dhe të progresit të përshpejtuar social ekonomik do të jetë një prioritet i pa ndarë i të gjitha ministrive dhe agjencive të vendit.

Ndërkohë Diella, ministrja e Shtetit për Inteligjencën Artificiale do të ushtrojë një ndikim vendimtar për përshpejtimin e këtij procesi. Ajo do të mbështetet nga një akselator me emrin AI 4, "Albanian Innovation 4" i cili do ketë lirinë e plotë të operojë me një rol të ri brenda administratës, plot fuqi në veprim, shembje të pengesave burokratike, adoptim me detyrim përcaktim të inteligjencës artificiale në çdo hap dhe në çdo fushë.

Akselatori AI 4 do të bashkojë talentet më të mira shqiptare brenda vendit duke tërhequr njëkohësisht shqiptarë në diasporë, por edhe të huaj që kanë dëshirë të hyjnë në konstelacionin e Diellës. Do të përquendrojë një masë kritike talentesh tek problemet më të vështira të Shqipërisë, sfida që zakonisht nuk i frymëzojnë startup-et por që janë kyç për përparimin kom-

bëtar. Do të ndërtojë kompani që mund të krijojnë vlerë të konsiderueshme për Shqipërinë dhe për shtetin si aksioner dhe të motivojnë më shumë shqiptarë që të nisin sipërmarrjet e tyre duke krijuar një cikël auto gjenerues inovacioni.

Diella me akselatorin e saj AI 4 do ta pozicionojë bukur Shqipërinë si një vend me ambicie të madhe në fushën e qeverisjes përmes digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale si dhe do kombinojë peshën e shtetit me zhdërvjelltësinë e startup-eve duke bashkuar në korsinë e përparimit, shërbimin publik me sipërmarrjen inovative dhe duke i kthyer institucionet në platforma zhvillimore të inteligjencës artificiale.

Unë jam i keq ardhur për kundërshtinë ndaj Dielles si anëtare e kabinetit të ri qeveritar dhe për keqkuptimet e mëdha lidhur me rolin dhe me pritshmërinë prej saj dhe duke qenë se Diella është e integruar në dekretin e presidentit si pjesë përgjegjësie e imja dhe për rrjedhojë duke qenë se koha e fjalës time është e vetmja kohë kur Diella mund t'i drejtohet kuvendit, atëherë para se të vazhdoj më tej me programin e qeverise së re kërkoj nga shërbimi i Kuvendit t'ia japë fjalën Diellës.

Presidenti Begaj takon Trump: Miqësia shqiptaro-amerikane, lidhje e pathyeshme



